FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 128

Tiranë – E premte, 18 korrik 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 231, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19027
Dekret i Presidentit nr. 232, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19027
Dekret i Presidentit nr. 233, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19027
Dekret i Presidentit nr. 234, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19027
Dekret i Presidentit nr. 235, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19028
Dekret i Presidentit nr. 236, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19028
Dekret i Presidentit nr. 237, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19028
Dekret i Presidentit nr. 238, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19029
Dekret i Presidentit nr. 239, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19029
Dekret i Presidentit nr. 240, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19029

Dekret i Presidentit nr. 241, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	19030
Dekret i Presidentit nr. 242, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	19030
Dekret i Presidentit nr. 243, datë 10.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	19030
Dekret i Presidentit nr. 248, datë 14.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	19030
Dekret i Presidentit nr. 249, datë 14.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	19031
Dekret i Presidentit nr. 250, datë 14.7.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	19031
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 16.7.2025	Për miratimin e përshkrimeve dhe të specifikimeve teknike të urdhrave dhe medaljeve, si dhe të certifikatave e letrave njoftuese për dorëzimin e tyre	19091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2025, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave	19063
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 16.7.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar	19064
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 16.7.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1085, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave"	19067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 16.7.2025	Për hapjen e pikës së kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës	19072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e rregullave, të procedurave dhe të kohëzgjatjes së mbrojtjes personale dhe banesës së personaliteteve të tjera pas përfundimit të detyrës	19072

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 16.7.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 348, datë 29.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit", të ndryshuar.....	19073
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 404, datë 16.7.2025	Për përcaktimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2023 për llogaritjen e pensioneve.....	19074
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.7.2025	Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.....	19075
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 10.6.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 4.4.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.....	19076
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 57/19, datë 16.7.2025	Për disa ndryshime në VKM-në nr. 231, datë 17.4.2019, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i segmentit rrugor 'Pallati me Shigjeta – rrethrrotullimi 'Shqiponja'""....	19085
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 541/8, datë 15.7.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Parku Natyror 'Liqeni i Ulzës' dhe zona e mbrojtur përreth tij", me vendndodhje në Bashkinë Mat.....	19087

DEKRET
Nr. 231, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Astrit Safet Fero
2. Agim Shaban Bejtaga
3. Flora Tomor Berikoven
4. Harilla Jani Steri
5. Henri Vladimir Agaraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 232, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Erion Ali Hamiti
2. Nikolin Mihal Kuteli
3. Alban Ilirjan Qinami
4. Vanessa Bashkim Qoli
5. Vasil Tasho Merko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 233, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Seçil Ramazan Türkmen Atlar

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 234, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr.

113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Monica Pietro Amaranti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 235, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ilda Alem Mehmeti
2. Anila Maliq Linz

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 236, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Sihana Halim Qarkaxhija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 237, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sazana Hamdi Qoli
2. Bashkim Musa Qoli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 238, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ajtanka Kristaq Heinzer
2. Stela Mersin Pushaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 239, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Enea Petraq Koçi
2. Anton Rakip Doçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 240, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bayrak Sydi Beratli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 241, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Afrim Hysen Beqa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 242, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Shpat Nafi Dafota

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 243, datë 10.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bilge Ayhan Hüsnü Atlar

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 248, datë 14.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Sara Lulzim Yzeiraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 249, datë 14.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Fatjona Dashnor Fané
2. Bationa Myslim Bennewitz

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 250, datë 14.7.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Romina Xhevdet Dibra
2. Adi Agron Dibra

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 396, datë 16.7.2025

PËR MIRATIMIN E PËRSHKRIMEVE DHE TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË URDHRAVE DHE MEDALJEVE, SI DHE TË CERTIFIKATAVE E LETRAVE NJOFTUESE PËR DORËZIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përshkrimeve dhe të specifikimeve teknike të urdhrave dhe medaljeve, si dhe të certifikatave e letrave njoftuese për dorëzimin e tyre, sipas lidhjeve 1, 2, 3 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LIDHJA 1

SPECIFIKIMET E DETAJUARA TË URDHRAVE DHE TË MEDALJEVE TË FORMATIT STANDARD

A. URDHRI SUPREM I SHQIPONJËS

1. GJERDANI

Sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 93/2022, Gjerdani është ekzemplar unik dhe atribut i presidentit në detyrë. Në kujtesën historike të shtetit shqiptar, një gjerdan, me funksione afërsisht të njëjta, ka qenë në fuqi në vitet 1925–1939. Në kontekstin e tanishëm, është e natyrshme përshtatja e disenjimit të gjerdanit të kreut të shtetit, kryetar i urdhrave, duke u lënë shteg disa ndryshimeve në detaje: zëvendësimi i yllit sipër shqiponjës me përkrenaren e Skënderbeut; vendosja e monogramit të Republikës "RSH" në shqytin qendror.

Duke pasur parasysh se gjerdani që do të punohet do të mbetet ekzemplar unik e do të mishërojë një nga simbolet e sovranitetit të shtetit (*Regalia*) përmes kalimit dorë më dorë nga një kryetar shteti tek tjetri, ai prodhohet prej ari masiv ose prej metali shumë të çmuar.



Gjerdani i Urdhrit Suprem të Shqiponjës përbëhet nga shqiponja e madhe në qendër e varur nga gjerdani. Shqiponja është dykrerëshe, sipas modelit zyrtar të vitit 1922, me përmasa në diametër 76 mm, me smalt të zi, përveç kokave dhe kthetrave, me punim njëfaqësh. Në gjoks mbart një shqyt me smalt të kuq me monogramin RSH (Republika e Shqipërisë) të stilizuar. E gjitha e gufuar lehtë 2–3 mm. Shqiponja është e kapur përsipër me anën e dy unazave të vogla me përkrenaren e Skënderbeut të stilizuar me vështrim heraldik majtas. Përsipër përkrenarja montohet me gjerdanin me një unazë të vogël, e cila kapet

midis dy shpatave të kryqëzuara me majë poshtë. Gjerdani përbëhet nga 9 shqiponja të alternuara me 10 degë dafine. Shqiponjat janë dykrerëshe me smalt të kuq pjesërisht të tejdukshëm, me përmasa në diametër 34 mm. Degët e dafinës janë të "*au naturel*" me nga një yll 5-cepësh në mes. Shqiponjat kapen me degët e dafinës në çdo anë me nga dy unaza të vogla. Kur nuk janë në ar masiv, Gjerdani dhe shqiponja e madhe punohen prej argjendi 960/999, të praruara prej ari 750/999.

2. YLLI I MADH



Ylli i Madh i USSH-së përbëhet nga:

1. një yll i madh 8-cepësh, me diametër 80 mm, me punim njëfaqësh, me smalt të bardhë, midis cepave të të cilit janë vendosur 8 shqiponja të vogla të stilizuara. Në qendër të yllit, në një medaljon me smalt të zi, është vendosur në reliev shqiponja dykrerëshe, sipas modelit zyrtar të vitit 1922. Medaljoni rrethohet nga një rreth në smalt të kuq, në gjysmën e poshtme të të cilit vendoset motoja e Urdhrit "BESË E BASHKIM", ndërsa në gjysmën e sipërme përkrenarja e Skënderbeut me vështrim heraldik djathtas. E gjitha është e gufuar në qendër rreth 10–15 mm. Në anën e pasme ylli ka një gjilpërë vertikale, me majë poshtë, për kapjen në xhaketë. Ylli punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999. Shqiponjat e vogla janë prej argjendi, ndërsa shqiponja qendrore në reliev është e punuar prej argjendi 960/999 e praruar prej ari 750/999;

2. dekorata e fashës së Yllit të Madh. Dekorata është përgjithësisht e njëjtë me Yllin e Madh, pra përbëhet nga një yll me 8 cepa, me diametër 58 mm, me punim njëfaqësh, me smalt të bardhë, në qendër të të cilit, në një medaljon me smalt të zi, është mbivendosur në reliev shqiponja dykrerëshe, sipas modelit zyrtar të vitit 1922. Përreth medaljonit të zi, një rreth me smalt të kuq, në gjysmën e poshtme të të cilit shkruhet motoja e Urdhrit "BESË E BASHKIM". E gjitha e gufuar lehtë 2–3 mm. Ylli punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999. Dekorata kapet përsipër, me anën e një çerniere horizontale, me përkrenaren e Skënderbeut, me vështrim heraldik djathtas, e cila kapet përsipër me anën e një unaze 12 mm në fjongon e fashës.

3. OFICERI I MADH

Oficeri i Madh i USSH-së përbëhet nga:

1. ylli, përgjithësisht i njëjtë me Yllin e Madh, por pa zbukurimet e shqiponjave në argjend në skaje dhe me një diametër më të vogël, prej 80 mm. Ylli punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999;

2. dekorata, e cila, e njëjtë me atë të fashës së Yllit të Madh, mbahet e varur në qafë me një shirit 50 mm (kravata).



4. KOMANDARI

Dekorata e Komandarit të USSH-së është e njëjtë me atë të fashës së Yllit të Madh dhe të kravatës së Oficerit të Madh, por nuk shoqërohet nga asnjë pllakë ose zbukurim tjetër.

5. OFICERI

Dekorata e Oficerit të USSH-së përbëhet nga Ylli, i cili, në kundërshtim me shkallët eprore, është jo tetë, por gjashtëcepësh, në shembullin e shkallëve fillestare të Urdhrit të Shqiponjës së Zezë të Principatës së Shqipërisë më 1914-n. Ylli është në argjend 960/990 të smaltuar dhe të praruar 750, me punim njëfaqësh, me dimensione 46 mm, i kapur me çernierë në formën e përkrenares së Skënderbeut me vështrim heraldik djathtas dhe i varur nga shiriti i Urdhrit në dimensione 37 mm. Mbahet në anën e majtë të kraharorit.

6. KALORËSI

Dekorata e Kalorësit të USSH-së përbëhet nga Ylli, i cili, ngjashëm me atë të Oficerit, është gjashtëcepësh. Ylli është në argjend 960/990 të smaltuar, me punim njëfaqësh, me dimensione 46 mm, i varur pa çernierë të veçantë (unazë 10 mm) nga shiriti i Urdhrit në dimensione 37 mm. Mbahet në anën e majtë të kraharorit.

B. URDHRI I SKËNDERBEUT
1. YLLI I MADH

Dekorata e Yllit të Madh të USK-së përbëhet nga:

1. një yll i madh 5-cepësh me diametër 74 mm, me majë poshtë dhe me krahë të diamantuara. Atij i mbivendoset një yll 5-cepësh me majë sipër, me smalt të bardhë me diametër 64 mm. Ylli është me punim njëfaqësh. Në qendër të yllit, në një shqyt me bordurë dyshe me smalt të kuq dhe të zi, është vendosur në basoreliev portreti i Skënderbeut, sipas autorit *Cristofano dell'Altissimo*, të ruajtur në galerinë "*Uffizi*" në Firence. Lart yllit, duke fshehur pjesërisht cepin e sipërm, gjendet përkrenarja e Skënderbeut e stilizuar me vështrim heraldik majtas. Midis dy yjeve gjendet një kurorë rrethore prej gjethesh lisi me smalt të gjelbër të tejdukshëm, e lidhur poshtë me një fasho gjysmë me smalt të kuq dhe gjysmë me smalt të zi. E gjitha është e gufuar në qendër rreth 10 mm. Në anën e pasme ylli ka një gjilpërë vertikale me majë poshtë për kapjen në xhaketë. Ylli i diamantuar punohet prej argjendi 960/999; ylli i smaltuar me të bardhë, kurora me gjethe lisi dhe përkrenarja e Skënderbeut punohen prej argjendi 960/999 të praruar 750/999, ndërsa shqyti qendror në reliev është prej argjendi 960/999 të praruar 750/999;

2. dekorata e fashës së Yllit të Madh. Dekorata është përgjithësisht e njëjtë me Yllin e Madh, porse asaj i hiqet baza e diamantuar dhe i reduktohet diametri në 58 mm. Baza e dekoratës është e gufuar lehtë 2–3 mm. Dekorata punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999. Dekorata kapet përsipër me anën e një çerniere horizontale, me përkrenaren e Skënderbeut me vështrim heraldik djathtas, e cila kapet përsipër me anën e një unaze 12 mm në fjongon e fashës (kordonit të madh).

2. OFICERI I MADH

Dekorata e Oficerit të Madh të USK-së përbëhet nga:

1. ylli, përgjithësisht i njëjtë me Yllin e Madh, por pa bazën e diamantuar dhe me një diametër më të vogël, prej 64 mm. Ylli punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999;

2. dekorata, e cila, e njëjtë me atë të fashës së Yllit të Madh, mbahet e varur në qafë me një shirit 50 mm (kravata).

3. KOMANDARI

Dekorata e Komandarit të USK-së është e njëjtë me atë të fashës së Yllit të Madh dhe të kravatës së Oficerit të Madh, por nuk shoqërohet nga asnjë pllakë ose zbukurim tjetër.

4. OFICERI

Dekorata e Oficerit të USK-së përbëhet nga Ylli, i cili është në argjend 960/990 të smaltuar dhe të praruar 750, me punim njëfaqësh, me dimensione 40 mm, i kapur me çernierë në formën e përkrenares së Skënderbeut, me vështrim heraldik majtas dhe i varur nga shiriti i Urdhrit në dimensione 37 mm. Kurora e lisit është e praruar, por jo e smaltuar. Mbahet në anën e majtë të kraharorit.

5. KALORËSI

Dekorata e Kalorësit të USK-së përbëhet nga Ylli, i cili është në argjend 960/990 të smaltuar, me punim njëfaqësh, me përmasa 40 mm, i varur pa çernierë të veçantë (unazë 10 mm) nga shiriti i Urdhrit në dimensione 37 mm. Kurora e lisit nuk është as e praruar dhe as e smaltuar. Mbahet në anën e majtë të kraharorit.

C. URDHRI I LISIT AKADEMIK

1. YLLI I MADH

Dekorata e Yllit të Madh të ULA-së përbëhet nga:

1. një yll i madh 4-cepësh me diametër 74 mm, me punim njëfaqësh, me majat e pozicionuara në formë rombi rrezatues me sipërfaqe të lëmuar dhe jo të diamantuar. Atij i mbivendoset një kurorë me gjethe lisi me smalt të gjelbër, me përmasa 35 x 45 mm. Ylli punohet prej argjendi 960/999; kurora e lisit me smalt të gjelbër punohet prej argjendi 960/999, të praruar prej ari 750/999;



2. dekorata e fashës së Yllit të Madh. Dekorata shfaq të njëjtën kurorë gjethesh lisi si ajo që i mbivendoset Yllit të Madh, por me përmasa 50 mm x 60 mm. Me fashën kapet me një unazë 12 mm. Është me punim njëfaqësh, prej argjendi 960/999, e praruar prej ari 750/999 dhe e smaltuar në të gjelbër.

2. KOMANDARI

Dekorata e Komandarit të ULA-së përbëhet nga kurora e gjetheve të lisit, e cila, e njëjtë me atë të fashës së Yllit të Madh, mbahet e varur në qafë me një shirit 50 mm (kravata).

3. KALORËSI

Dekorata e Kalorësit të ULA-së përbëhet nga kurora e gjetheve të lisit, me punim njëfaqësh, me përmasa 35 mm x 45 mm, prej argjendi 960/999, e praruar prej ari 750/999, por e jo e smaltuar. Varet nga shiriti i urdhrit me përmasa 37 mm dhe mbahet në anën e majtë të kraharorit.

Ç. MEDALJET QË JEPEN NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS

1. MEDALJA E MERITËS USHTARAKE

Medalja e Meritës Ushtarake paraqet në anën kryesore, në reliev, shqiponjën dykrenore sipas variantit zyrtar të vitit 1922, me një shpatë në kthetra, në një medaljon me diametër 35 mm. Përreth, kurorë me gjethe dafine me gjerësi 4 mm. Në anën e pasme fusha lihet e lirë për të gdhendur emrin e mbajtësit dhe datën e dhënies së medaljes. Medalja lidhet përsipër me anën e një çerniere me përkrenaren e Skënderbeut të stilizuar me vështrim heraldik majtas. Në të dyja anët e përkrenares janë nga dy flamuj të shpalosur pjesërisht, që formojnë së bashku figurën e trofeut. Përkrenarja dhe flamujt i mvishen shiritit, duke u kapur me të përmes një unaze të sheshtë horizontale të salduar prapa flamujve. Medalja ka diametër 35 mm.

Medalja e artë, kur nuk prodhohet prej ari masiv, punohet prej argjendi 925/999 të praruar prej ari 750/999.

Medalja e argjendtë punohet prej argjendi 925/999.

Medalja e bronztë punohet prej bronzi.

2. MEDALJA E MERITËS CIVILE

Medalja e Meritës Civile paraqet në anën kryesore, në reliev, shqiponjën dykrenore sipas variantit zyrtar të vitit 1922, në një medaljon me diametër 35 mm. Përreth, kurorë me gjethe dafine me gjerësi 4 mm. Në anën e pasme fusha lihet e lirë për të gdhendur emrin e mbajtësit dhe datën e dhënies së medaljes. Medalja ka diametër 35 mm.

Medalja e artë, kur nuk prodhohet prej ari masiv, punohet prej argjendi 925/999 të praruar prej ari 750/999.

Medalja e argjendtë punohet prej argjendi 925/999.

Medalja e bronztë punohet prej bronzi.

3. MEDALJA “NËNË TEREZA”

Medalja “Nënë Tereza” paraqitet si një yll me 4 cepa, i përshtatur në formën e një rombi rrezatues në reliev. Në qendër, brenda një medaljoni është vendosur portreti i Nënë Terezës. Medalja ka diametër 44 mm.

Medalja e artë punohet prej argjendi 925/999 të praruar prej ari 750/999.

Medalja e argjendtë punohet prej argjendi 925/999.

Medalja e bronztë punohet prej bronzi.

4. MEDALJA “PISHTAR I DEMOKRACISË”

Medalja “Pishtar i Demokracisë” paraqitet në formë rrethore me simbolin e flakës së pashuar në qendër, e cila gjallon nga një burim i zbukuruar me gjethe dafine. Në sfond dallohet një kompozim rrezesh dhe telash me gjemba. Rreth pjesës së poshtme të medaljes është shkruar me shkronja të mëdha të ngritura në reliev “PISHTAR I DEMOKRACISË”. Në anën e pasme fusha lihet e lirë për të gdhendur emrin e mbajtësit dhe datën e dhënies së medaljes. Medalja ka diametër 35 mm.

Medalja punohet prej bronzi.

D. MEDALJA QË JEPET NGA KRYEMINISTRI

1. MEDALJA PËR MIRËNJOHJE PUBLIKE

Medalja e Artë [Kordoni i Madh me Yll i Mirënjohjes Publike] paraqet një yll 6-cepësh të stilizuar, me punim njëfaqësh, me smalt të kuq, me përmasa 90 mm x 76 mm. Yllit i mbivendoset një shqiponjë dykrenore në reliev, sipas variantit në figurë, me përmasa 40 x 37 mm. Në anën e pasme ylli ka një gjilpërë vertikale me majë poshtë, për kapjen në xhaketë. Dekorata punohet prej argjendi 960/999, të praruar 750/999.

Medalja e Artë shoqërohet nga një fashë, që përfundon me një dekoratë, e cila është përgjithësisht e njëjtë me Yllin, ku ylli i kuq ka diametër 70 mm. Dekorata kapet përsipër, me anën e një çerniere horizontale, me një kurorë gjethesh lisi dhe dafine me diametër 28 mm, e cila kapet përsipër me anën e një unaze 12 mm në fjongon e fashës.

Medalja e argjendit [Ylli i Madh i Mirënjohjes Publike] është e njëjtë me Medaljen e Artë, përveç faktit që ylli ka përmasa 60 mm x 51 mm dhe vendoset me shirit përreth qafës. Dekorata kapet përsipër, me anën e një çerniere horizontale, me një kurorë gjethesh lisi dhe dafine me diametër 26 mm. Kurora është e kapur lart me dy hallka, që bëjnë lidhjen me kapësen me përmasa 35 mm x 4.8mm. Ajo shoqërohet nga një pllakë e ngjashme me Yllin e Madh, por me përmasa 80 mm x 68 mm.

Medalja e Bronzit [Ylli i Mirënjohjes Publike] është e njëjtë me Medaljen e Artë, përveç faktit që ylli i ka përmasat 50 mm x 43 mm dhe shiriti është me gjerësi 22 mm. Dekorata kapet përsipër, me anën e një çerniere horizontale, me një kurorë gjethesh lisi dhe dafine me diametër 25 mm. Kurora është e kapur lart me dy hallka, që bëjnë lidhjen me kapësen me përmasa 22 mm x 4.8mm.

DH. MEDALJET QË JEPEN NGA MINISTRAT
1. MEDALJA E SHËRBIMIT USHTARAK

Medalja e Shërbimit Ushtarak paraqitet në formë rrethore me simbol qendror shqiponjën dykrenore në modelin *art deco* të viteve 1930, e cila mban në kthetra një shpatë dhe mbi krye përkrenaren e Skënderbeut, me vështrim heraldik majtas. Nga njëri skaj në tjetrin të flatrave shkruhet legjenda "Shërbim Ushtarak". Medalja ka diametër 35 mm.

Medalja e artë punohet prej argjendi 925/999 të praruar 750/999.

Medalja e argjendtë punohet prej argjendi 925/999.

Medalja e bronztë punohet prej bronzi.

2. MEDALJA E SHËRBIMIT TË RENDIT PUBLIK

Medalja e Shërbimit të Rendit Publik paraqitet në formë rrethore me simbol qendror shqiponjën dykrenore në modelin e përdorur sot gjerësisht në shenjat e Policisë së Shtetit. Në të dyja anët e saj janë vendosur simbolet e forcës së ligjit (shpata) dhe të zbatimit të tij (skeptri i drejtësisë). Nën simbolet e përshkruara më sipër shkruhet legjenda "Për Shërbim në Rendin Publik". Medalja ka diametër 35 mm.

Medalja e artë punohet prej argjendi 925/999 të praruar 750/999.

Medalja e argjendtë punohet prej argjendi 925/999.

Medalja e bronztë punohet prej bronzi.

LIDHJA 2

SPECIFIKIMET E DETAJUARA TË SHIRITAVE TË URDHRAVE DHE MEDALJEVE

1. Shiritat duhet të jenë prej mëndafshi të tipit "me ujëra" [mëndafsh i ujësuar].

2. Shiritat kanë gjerësi:

- për Yllin e Madh dhe klasën I të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike: 101 mm;
- për Oficerin e Madh, Komandarin dhe klasën II të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike: 50 mm;
- për klasën III të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike: 30 mm;
- për Oficerin, Kalorësin dhe medaljet e tjera: 37 mm;
- për miniaturat e Urdhrave dhe të Medaljeve, pa dallim: 10–12 mm.



SHEMBULL - PERMASAT (në milimetra)



SHEMBULL - PERMASAT (në milimetra)



SHEMBULL – PËRMASAT E MEDALJEVE NË MILIMETRA



3. Shiriti i Yllit të Madh të Urdhrave dhe të klasës I të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike ka gjatësi rreth 2 m, me skajet fundore të prera zigzag. Fundet e shiritit bashkohen në distancë rreth 10–12 cm nga skajet e tyre me anën e një fjongoje prej të njëjtit material, në të cilën varet dekorata përkatëse.

4. Shiriti i Oficerit të Madh dhe Komandarit të Urdhrave, si dhe të klasave II dhe III të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike ka gjatësi rreth 50 cm dhe përfundon në të dyja skajet me nga një shirit të hollë, që shërben për t'u lidhur rreth jakës së këmishës.

5. Shiriti i Oficerit dhe Kalorësit të Urdhrave ka gjatësi rreth 20 cm, i palosur në dysh përmes unazës varëse të dekoratës.

6. Shiriti i Medaljeve ka gjatësi rreth 20 cm, i palosur më dysh përmes çernierës ose unazës varëse të medaljes.

7. Shiriti i Urdhrit Suprem të Shqiponjës është 101 mm, i kuq me nga një vijë të zezë 11 mm në skaje. Shiriti i shkallëve të tjera ka ngjyra të njëjta, duke ruajtur proporcionet përkatëse.

8. Shiriti i Urdhrit të Skënderbeut është 101 mm, bordò me nga një kombinim zi-kuq-zi në distancë 7 mm nga skajet. Shiriti i shkallëve të tjera ka ngjyra të njëjta, duke ruajtur proporcionet përkatëse.

9. Shiriti i Urdhrit të Lisit Akademik është 101 mm, violet e errët, me nga një vijë të gjelbër 10 mm, në distancë 9 mm nga skajet.

10. Shiriti i Medaljes së Meritës Ushtarake është i kuq.

11. Shiriti i Medaljes së Meritës Civile është i gjelbër.

12. Shiriti i Medaljes "Nënë Tereza" është bardhë e kaltër. Në skajin e bardhë ka një vijë të kuqe 5.5 mm ndërsa në skajin e kaltër ka një vijë të zezë 5.5 mm.

13. Shiriti i Medaljes "Pishtar i Demokracisë" është i zi i përshkuar në gjerësi dhe gjatësi të barabartë nga 6 vija të verdha në njërën anë dhe në tjetrën të shiritit dhe nga një vijë e kuqe në mes.

14. Shiriti i Medaljes së Mirënjohjes Publike është i zi përshkuar nga një vijë e kuqe qendrore 4 mm.

15. Shiriti i Medaljeve përkujtimore, ushtarake dhe civile, ka ngjyra që përcaktohen rast pas rasti me aktin themelues të tyre. Shenjë dalluese e tyre është fakti që shiriti, në çdo rast, ka në skajet e tij nga një vijë gri 2 mm.

16. Shiriti i Medaljes së Shërbimit Ushtarak është i kuq me një shirit qendror gri 4 mm.

17. Shiriti i Medaljes së Shërbimit të Rendit Publik është i kuq me një shirit qendror blu 4 mm.

LIDHJA 3

1. MINIATURAT [FORMATI *MIGNON*]; SHENJAT PËR UNIFORMAT USHTARAKE [BARRETA ose DIKSMUDA]; ROZETAT

Urdhrat dhe medaljet në formatin *mignon* janë të standardit ndërkombëtar dhe paraqesin dekoratën përkatëse të zvogëluar në madhësi nga 12 mm deri në 25 mm. Miniaturat nuk mund të jenë më të vogla se 10 mm.

Shiriti *mignon*, në mëndafsh të ujësuar, është standard me gjerësi 10–13 mm dhe prodhohet sipas ngjyrave përkatëse të secilit urdhër dhe medalje.

Shenjat për uniformat ushtarake në përdorim të përditshëm [jo *galà*], që njihen edhe si *barrette dixmude* kanë përmasa standarde 37 x 10–12 mm, me ngjyrat sipas dekoratës përkatëse dhe punohen në material mëndafsh të ujësuar.

Rozetat e urdhrave dhe të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike janë të formatit ndërkombëtar dhe kanë diametër, që varion nga 6 në 12 mm, me ngjyrat sipas dekoratës përkatëse.

2. SIMBOLET DALLUESE TË SHKALLËVE NË MINIATURA, BARRETA DHE ROZETA

Simbolet dalluese të shkallëve të urdhrave dhe disa medaljeve përcaktohen sa herë mbahen formatet e zvogëluara të dekoratave dhe jo formatet e rregullta.

Për urdhrat dhe Medaljen e Kryeministrit për Mirënjohje Publike dallimi bëhet kryesisht përmes rozetës:

1. Për Yllin e Madh të urdhrave dhe klasën I të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike përdoret një rozetë në mëndafsh të ujësuar me ngjyrat përkatëse mbi një shtrat në mëndafsh të ngrirë të praruar. Kjo rozetë ngjitet, me qëllim dallimin e shkallës, edhe në shiritat e formatit *mignon* dhe në shenjat e uniformave të ushtarakëve.

2. Për Oficerin e Madh të Urdhrave përdoret një rozetë në mëndafsh të ujësuar me ngjyrat përkatëse mbi një shtrat në mëndafsh të ngrirë gjysmë të praruar dhe gjysmë të argjendtë. Kjo rozetë ngjitet, me qëllim dallimin e shkallës, edhe në shiritat e formatit *mignon* dhe në shenjat e uniformave të ushtarakëve.

3. Për Komandarin e Urdhrave dhe klasën II të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike përdoret një rozetë në mëndafsh të ujësuar me ngjyrat përkatëse mbi një shtrat në mëndafsh të ngrirë të argjendtë. Kjo rozetë ngjitet, me qëllim dallimin e shkallës, edhe në shiritat e formatit *mignon* dhe në shenjat e uniformave të ushtarakëve.

4. Për Oficerin e Urdhrave përdoret një rozetë në mëndafsh të ujësuar me ngjyrat përkatëse. Mbi rozetë ngulet përkrenarja e Skënderbeut, me vështrim heraldik djathtas për Urdhrin Suprem të Shqiponjës dhe me vështrim heraldik majtas për Urdhrin e Skënderbeut. Kjo rozetë ngjitet, me qëllim dallimin e shkallës, edhe në shiritat e formatit *mignon* dhe në shenjat e uniformave të ushtarakëve.

5. Për Kalorësin e Urdhrave dhe për klasën III të Medaljes së Kryeministrit për Mirënjohje Publike përdoret një rozetë në mëndafsh të ujësuar me ngjyrat përkatëse pa shenjë tjetër dalluese. Shiritat e formatit *mignon* dhe shenjat e uniformave të ushtarakëve të këtyre shkallëve nuk shoqërohen nga rozeta.

SHEMBULL – ROZETAT E YLLIT TË MADH, KOMANDARIT DHE KALORËSIT TË URDHRIT SUPREM TË SHQIPONJËS DHE TË KLASAVE I, II, III TË MEDALJES SË KRYEMINISTRIT PËR MIRËNJOHJE PUBLIKE

SHEMBULL – ROZETAT E YLLIT TË MADH, KOMANDARIT DHE KALORËSIT TË URDHRIT TË SKËNDERBEUT

SHEMBULL – ROZETAT E YLLIT TË MADH, KOMANDARIT DHE KALORËSIT TË URDHRIT TË LISIT AKADEMIK

6. Përjashtimisht nga sa më sipër, Presidenti i Republikës në detyrë, dhe pas lënies së detyrës, në cilësinë e Kryetarit të Urdhrave dhe mbajtësit të Gjerdanit, mund të zbukurojë shiritin e formatit *mignon* ose barretën e Urdhrit Suprem të Shqiponjës me një shqiponjë dykrenore të artë në vend të rozetës.

7. Ushtarakët që janë dekoruar sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 20, të ligjit nr. 93/2022, zbukurojnë shiritat e dekoratës së akorduar me dy shpata të kryqëzuara.



8. Për disa medalje, dallimi i shkallëve përcaktohet përmes simboleve të veçanta:
- Medalja e Meritës Ushtarake:
1. Medalja e Artë: 3 përkrenare të Skënderbeut në shenjat e uniformës;
2. Medalja e Argjendtë: 2 përkrenare të Skënderbeut në shenjat e uniformës;
3. Medalja e Bronztë: 1 përkrenare të Skënderbeut në shenjat e uniformës.

- Medaljet e Shërbimit Ushtarak dhe të Shërbimit të Rendit Publik:
1. Medaljet e Arta: një yll pesëcepësh i praruar në shenjat e uniformës;
2. Medaljet e Argjendta: një yll pesëcepësh i argjendtë në shenjat e uniformës;
3. Medaljet e Bronzit nuk shoqërohen nga shenja të veçanta.

9. Nga prapa, shenjat kanë të salduara 2 copa teli, që shërbejnë për montimin e tyre në shiritin e medaljes. Shenjat prodhohen prej llamarine të stampuar të praruar, ndërsa yjet të praruar dhe të argjenduar.

3. TOLERANCAT E LEJUARA

Për të gjitha objektet e përshkruara, toleranca e lejueshme në përmasa (kur nuk është përcaktuar ndryshe) është deri ±3%. Kjo tolerancë i shërben harmonizimit vizual të pjesëve përbërëse të dekoratave dhe shiritave.

LIDHJA 4

A. CERTIFIKATAT E URDHRAVE

Certifikatat e urdhrave janë prej kartoni të një cilësie të lartë, me përmasa standarde A3 (420 x 297 mm).

Certifikata tip përmban, në qendër lart, shkrimin "Republika e Shqipërisë". Më poshtë, po në qendër, vendoset shkrimi "Urdhri …". Poshtë shkrimeve, në qendër, shfaqet pamja e pikturuar e shenjave të Komandarit të Urdhrit përkatës. Në rastin e Urdhrit Suprem të Shqiponjës, në të dyja anët e shenjave shkruhet motoja e tij "Besë e Bashkim". Më pas vijohet me tekstin për secilin të dekoruar të miratuar nga Kancelaria.

Poshtë në qendër majtas është vula e thatë e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve bazuar mbi logon përkatëse së bashku me shkrimin "Kryetari i Kolegjit", emër, mbiemër dhe nënshkrim; ndërsa djathtas "Presidenti i Republikës", emër, mbiemër dhe nënshkrim, shoqëruar nga vula e institucionit.

B. LETRAT E NJOFTIMIT TË MEDALJEVE

Letrat e njoftimit të Medaljeve janë prej kartoni të një cilësie të lartë, me përmasa standarde A4 (210 x 297 mm).

Letra e njoftimit tip përmban në qendër lart stemën e Republikës dhe shkrimin "Republika e Shqipërisë". Më pas vijohet me tekstin për secilin të dekoruar të miratuar nga Kancelaria, i cili vendoset mbi një imazh të medaljes të printuar në sfond.

Poshtë në qendër majtas është vula e thatë e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve, bazuar mbi logon përkatëse së bashku me shkrimin "Kryetari i Kolegjit", emër, mbiemër dhe nënshkrim; ndërsa djathtas "Presidenti i Republikës", emër, mbiemër dhe nënshkrim, shoqëruar nga vula e institucionit.

Letrat e njoftimit të Medaljes së Meritës Ushtarake dhe Meritës Civile kanë përshkrim të detajuar të motivacionit të miratuar nga Kancelaria.

VENDIM
Nr. 397, datë 16.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2025, PËR BASHKËSITË FETARE, QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3, 4, 5 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, "Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave", dhe të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 113 000 000 (njëqind e trembëdhjetë milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2025, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 33 840 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 17 040 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyzet mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 71 (shtatëdhjetë e një) punonjës të administratës;

ii. 16 800 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 70 (shtatëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 26 400 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e mijë) lekë, të ndarë në:

i. 13 200 000 (trembëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës të administratës;

ii. 13 200 000 (trembëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 26 400 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 (dyzet) punonjës të administratës;

ii. 16 800 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 70 (shtatëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 26 360 000 (njëzet e gjashtë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të ndarë në:

i. 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë për financimin, deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 25 (njëzet e pesë) punonjës të administratës;

ii. 13 360 000 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, si kontribut në ndërtimin e Teqesë së Shtufit, Gjirokastër;

iii. 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2025, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet njëherësh, brenda muajit korrik të vitit 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 398, datë 16.7.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 25, të kreut I, pas fjalëve "...(CFSP) 2025/931..." shtohen "...(CFSP) 2025/1320...".

2. Në aneksin 25, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/1320, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Fletorja Zyrtare
e Bashkimit Evropian

SHQIP
Seria L

2025/1320

30.6.2025

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/1320

e 30 qershorit 2025

që ndryshon Vendimin 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet e Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Meqë:

(1) Më 31 korrik 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/512/CFSP([1]).

(2) Në Rezolutën e saj ES-11/7, të miratuar më 24 shkurt 2025, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara rikujtoi nevojën për zbatimin e plotë të rezolutave të saj përkatëse të miratuara në përgjigje të agresionit kundër Ukrainës, në veçanti kërkesën e saj që Federata Ruse të tërheqë menjëherë, plotësisht dhe pa kushte të gjitha forcat e saj ushtarake nga territori i Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, dhe kërkesën e saj për një ndërprerje të menjëhershme të armiqësive nga Federata Ruse kundër Ukrainës, në veçanti të çdo sulmi kundër civilëve dhe objekteve civile.

(3) Për sa kohë që veprimet e paligjshme të Federatës Ruse vazhdojnë të shkelin rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë, në veçanti, ndalimin e përdorimit të forcës të sanksionuar në Nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ose të së drejtës ndërkombëtare humanitare, është e përshtatshme të mbahen në fuqi të gjitha masat e vendosura nga Bashkimi dhe të merren masa shtesë, nëse është e nevojshme. Si pasojë, Vendimi 2014/512/CFSP duhet të rinovohet për 6 muaj të tjerë.

(4) Prandaj, Vendimi 2014/512/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Në Vendimin 2014/512/CFSP, Neni 9(1) zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

'1. Ky Vendim do të zbatohet deri më 31 janar 2026.'

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas botimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Bërë në Bruksel, më 30 qershor 2025.

Për Këshillin

Presidenti

A. SZŁAPKA

([1]) Vendimi i Këshillit 2014/512/CFSP i 31 korrikut 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet e Rusisë për destabilizimin e situatën në Ukrainë (OJ L 229, 31.7.2014, f. 13, ELI:http://data.europa.eu/eli/dec/2014/512/oj).

Official Journal of the European Union
EN
L series

2025/1320
30.6.2025

COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/1320

of 30 June 2025

amending Decision 2014/512/CFSP concerning restrictive measures in view of Russia's actions destabilising the situation in Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 31 July 2014, the Council adopted Decision 2014/512/CFSP [1].

(2) In its Resolution ES-11/7, adopted on 24 February 2025, the United Nations General Assembly recalled the need for the full implementation of its relevant resolutions adopted in response to the aggression against Ukraine, in particular its demand that the Russian Federation immediately, completely and unconditionally withdraw all of its military forces from the territory of Ukraine within its internationally recognised borders, and its demand for an immediate cessation of the hostilities by the Russian Federation against Ukraine, in particular of any attacks against civilians and civilian objects.

(3) As long as the illegal actions by the Russian Federation continue to violate fundamental rules of international law, including, in particular, the prohibition on the use of force enshrined in Article 2(4) of the Charter of the United Nations, or of international humanitarian law, it is appropriate to maintain in force all the measures imposed by the Union and to take additional measures, if necessary. Consequently, Decision 2014/512/CFSP should be renewed for a further 6 months.

(4) Decision 2014/512/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

In Decision 2014/512/CFSP, Article 9(1) is replaced by the following:

'1. This Decision shall apply until 31 January 2026.'.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 30 June 2025.

For the Council
The President
A. SZŁAPKA

[1] Council Decision 2014/512/CFSP of 31 July 2014 concerning restrictive measures in view of Russia's actions destabilising the situation in Ukraine (OJ L 229, 31.7.2014, p. 13, ELI: http://data.europa.eu/eli/dec/2014/512/oj).

VENDIM
Nr. 400, datë 16.7.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1085, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PËR BLERJEN E PAJISJEVE/MJETEVE TË PROJEKTUARA POSAÇËRISHT OSE TË PËRSHTATURA PËR QËLLIME USHTARAKE, SI DHE ARMËT, MUNICIONET APO MATERIALET LUFTARAKE PËR QËLLIME OPERACIONALE, PËRFSHIRË TEKNOLOGJINË DHE *SOFTWARE*-T E LIDHURA ME KËTO MALLRA, SI DHE PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VEÇANTË TË KLASIFIKIMIT TË KËTYRE KONTRATAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronjat "dh" e "i", dhe 2, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1085, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/ mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titull, pas fjalës "... përfshirë ..." shtohet "... shërbimet, ...".

2. Në të gjithë tekstin e vendimit, pas fjalëve "agjenci/a/së/e/ve/të/në e/të NATO-s" dhe "agjencisë së saj" shtohen "ose vend/e partner/e i/të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të NATO-s ose agjenci e/të tij/tyre.".

3. Në shkronjën "a", të nenit 1, pas fjalës "... përfshirë ..." shtohet "... shërbimet, ...".

4. Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1 shtohen fjalët "... ose struktura varësie apo shoqëri aksionare shtetërore, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e industrisë ushtarake të autorizuara nga Ministria e Mbrojtjes.";

b) Në shkronjën "c", të pikës 4, fjalët "... ndërmarrjet ushtarake ..." zëvendësohen me "... dhe ...";

c) Pas pikës 21 shtohet pika 21.1, me këtë përmbajtje:

"21.1. "Dialogu negociues" është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor kryen dialog me shoqërinë aksionare me kapital shtetëror, mbi mundësinë e realizimit të një kontrate me këtë subjekt.".

5. Në nenin 6, pas fjalës "... përfshirë ..." shtohet "... shërbimeve, ..."

6. Në shkronjën "c", të pikës 6, të nenit 8, pas fjalës "... projektit ..." shtohen fjalët "... duke iu përmbajtur dhe përditësuar specifikimet teknike, parashikuar në kërkesën operacionale ...".

7. Në pikën 1, të nenit 10, fjalët "... ministrit të Mbrojtjes ..." zëvendësohen me "... titullarit të autoritetit kontraktor ...".

8. Në pikën 1, të nenit 11, fjalët "... ministrit të Mbrojtjes ..." zëvendësohen me "... titullarit të autoritetit kontraktor ...".

9. Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 16/1
Arsyet/kriteret e shkualifikimit të kandidatëve ose të ofertuesve

1. Autoriteti kontraktor shkualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave për prokurime, që zhvillohen sipas këtij vendimi, çdo operator ekonomik, kur ka të dhëna se ai është ose ka qenë i dënuar me vendim penal të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:

a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) Korrupsion;

c) Mashtrim;

ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) Vepra me qëllime terroriste, vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, nxitje, ndihmë ose

mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;

dh) Organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) Falsifikim;

ë) Keqtrajtim i të miturve, sipas nenit 124/b të Kodit Penal, dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Detyrimi për të shkualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë ose bashkëshorti/bashkëshortja është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i operatorit ekonomik apo ka kompetenca përfaqësuese vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

3. Autoriteti kontraktor shkualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave për prokurime, që zhvillohen sipas këtij vendimi, çdo operator ekonomik, nëse:

a) ka falimentuar apo është në likuidim, punët/ çështjet e tij po administrohen nga një gjykatë, ka bërë marrëveshje me kreditorë, ka pezulluar aktivitetet e biznesit ose është në një situatë të ngjashme, të ardhur si pasojë e një procedure të ngjashme, sipas legjislacionit në fuqi;

b) është subjekt i procedimeve për deklarimin e falimentimit, për një urdhër likuidimi apo administrimi të detyrueshëm nga një gjykatë, apo një rregullimi me kreditorë, apo ndonjë procedimi të ngjashëm, sipas legjislacionit në fuqi;

c) nuk ka përmbushur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

ç) nuk ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

4. Autoriteti kontraktor shkualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave për prokurime, që zhvillohen sipas këtij vendimi, çdo operator ekonomik, nëse ai apo edhe përfaqësuesi i tij ligjor, pronari, aksionarët e tij janë gjetur, mbi bazën e provave apo të informacioneve të vërtetuara, duke përfshirë edhe ato të përfituara nga burimet e mbrojtura me ligj, se përbëjnë rrezik të papranueshëm sigurie.

5. Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë, rast pas rasti, kritere të tjera për kualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve, në varësi të natyrës së procedurës së prokurimit.

6. Arsyet e shkualifikimit të kandidatëve ose të ofertuesve listohen në njoftimin e kontratës që publikohet.".

10. Në pikën 3, të nenit 17, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "a", pas fjalës "... financiare." shtohen fjalët "... në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit.";

b) Në shkronjën "b", pas togfjalëshit "... xhiros vjetore ..." shtohen fjalët ".... , vlera e të cilave nuk mund të tejkalojë 50% të vlerës limit të kontratës që prokurohet, ...";

c) Në shkronjën "c", pas fjalës "... procedurave." shtohen fjalët "... dhe të argumentuara nga autoriteti kontraktor në një procesverbal të veçantë.".

11. Pas pikës 3, të nenit 18, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Dialogu negociues.".

12. Pas shkronjës "e", të pikës 2, të nenit 20, shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) Kur ka një vendimmarrje të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë mbi një projekt specifik.".

13. Neni 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 21
Procedura "shtet me shtet"

1. Procedura "shtet me shtet" realizohet për:

a) furnizimin me pajisje ushtarake ose pajisje të klasifikuara;

b) punë dhe shërbime, që lidhen drejtpërdrejt me këto pajisje;

c) punë dhe shërbime të posaçme për qëllime ushtarake ose punë dhe shërbime, që, për arsye sigurie, përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar.

2. Procedurat "shtet me shtet" mund të realizohen në një nga format e mëposhtme:

a) Drejtpërdrejt me një vend anëtar të NATO-s ose me një agjenci të NATO-s;

b) Nëpërmjet dhënies së autorizimit një vendi anëtar të NATO-s ose agjencie të NATO-s për të kryer procedurat e prokurimit, nëpërmjet marrëveshjeve teknike ose nëpërmjet një kërkese të veçantë për prokurim;

c) Drejtpërdrejt ose nëpërmjet dhënies së autorizimit me një vend partner të NATO-s ose një agjencie të tyre nëpërmjet ose bazuar në një marrëveshje qeveritare;

ç) Drejtpërdrejt ose nëpërmjet dhënies së autorizimit me vende partnere të Republikës së Shqipërisë ose një agjencie të tyre, pas miratimit paraprak të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, nëpërmjet ose bazuar në një marrëveshje qeveritare.

3. Procedura e drejtpërdrejtë me vendin ose agjencinë, sipas përkufizimeve në këtë vendim, është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor prokuron mallra dhe shërbime nga ose nëpërmjet këtyre institucioneve, me kushtet, çmimet e standardet, që ato zbatojnë për forcat e tyre të armatosura.

4. Procedura me dhënie autorizimi njërit prej institucioneve të cituara në këtë vendim është procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor autorizon një nga institucionet në fjalë për të realizuar prokurimin në interes të Forcave të Armatosura, me procedurën, kushtet, çmimet e standardet, që ato zbatojnë për forcat e tyre të armatosura. Në këtë rast, autoriteti kontraktor mund të transferojë paraprakisht fondin financiar te shteti përkatës ose agjencia përkatëse, pas autorizimit të marrë nga ministria përgjegjëse për financat.

5. Procedurat "shtet me shtet" mund të bëhen me kontrata njëvjeçare ose kontrata disavjeçare.

6. Procedura e prokurimit "shtet me shtet" përfshin nënshkrimin e marrëveshjes teknike ose, në mungesë të saj, dërgimin e kërkesës së veçantë vendit/agjencisë përkatëse, të cilave u delegohet realizimi i procedurës së prokurimit, sipas sistemit të tyre të prokurimit. Ky lloj prokurimi mund të realizohet në këto raste:

a) Në rastin e ekzistencës së një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet shteteve për një fushë/objekt të caktuar, në kuadër të sigurisë dhe mbrojtjes;

b) Kur testimi i mallit të caktuar kërkon analizë teknike komplekse dhe Forcat e Armatosura nuk kanë mundësi ta kryejnë atë;

c) Në rastet e mospasjes së një ekspertize të mjaftueshme/nevojshme për objektin e prokurimit;

ç) Kur një formë tjetër prokurimi e përcaktuar në këtë vendim ka dështuar ose ka argumente të qëndrueshme, që dëshmojnë për mungesë leverdie, për shkak të çmimit ose të cilësisë së dobët së mallit;

d) Kur ekzistojnë kontrata të mëparshme të kësaj kategorie, prokurime "shtet me shtet" dhe ajo vlerësohet më e leverdishme sesa blerja e drejtpërdrejtë te një subjekt ekonomik, që operon me këtë shtet ose me shtete të tjera;

dh) Kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit, apo të parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, dhe kur afati kohor limit për procedura të konkurrimit nuk mund të realizohet dhe ekzistojnë rrethana të besueshme. Rrethanat e krijuara, në asnjë rast, nuk duhet të përdoren për investimet komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor;

e) Në raste urgjencash, kur cenohet niveli i gatishmërisë dhe operacionalitetit të strukturave të Forcave të Armatosura;

ë) Kur nuk mund të gjenden operatorë ekonomikë në treg;

f) Kur shteti/agjencia përkatëse përballon një pjesë të mallit ose shërbimit në vlerë monetare ose në natyrë, por jo më pak se 15% e vlerës totale të mallit ose të shërbimit, që kërkohet të prokurohet.

7. Në procedurën "shtet me shtet" autoriteti kontraktor ndjek këta hapa:

a) Pas hartimit të kërkesës operacionale nga struktura gjeneruese dhe të klasifikimit të saj nga komisioni i veçantë i klasifikimit, struktura përgjegjëse pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet grupit të punës për hartimin e projektit, harton projektin teknik me të gjithë informacionin e mundshëm, duke përcaktuar kërkesa sa më të plota e të sakta tekniko-operacionale;

b) Projekti teknik dhe rekomandimi për llojin e procedurës "shtet me shtet" i dërgohen titullarit të autoritetit kontraktor për miratim;

c) Me miratimin nga titullari, struktura përgjegjëse pranë autoritetit kontraktor i drejtohet vendit ose agjencisë së saj dhe negocion me të kushtet e projektit, ku përcaktohen edhe afatet e dërgimit nga kjo e fundit të ofertës teknike dhe ekonomike;

ç) Autoriteti kontraktor e vlerëson këtë ofertë dhe vendos nëse do të vijojë apo jo me nënshkrimin e saj.".

14. Pas nenit 21 shtohen nenet 21/1 dhe neni 21/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 21/1
Rastet e mundshme të autorizimit të shoqërive aksionare me kapital shtetëror për furnizimin e Forcave të Armatosura me armë, municione, pajisje dhe teknologji ushtarake

1. Ministria e Mbrojtjes rakordon me shoqërinë aksionare me kapital shtetëror mbi mundësinë e plotësimit të nevojave të Forcave të Armatosurave, sipas kërkesave operacionale brenda fushës së veprimtarisë së saj, apo mbi bazën e një informacioni të vënë në dispozicion nga kjo shoqëri.

2. Në rastet kur shoqëria me kapital shtetëror disponon të paktën 50% të kapaciteteve të vlerësuara si të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës në fjalë ose zotëron shumicën e kapitalit të nënshkruar të subjektit, që është krijuar për këtë qëllim, Ministria e Mbrojtjes mund të blejë drejtpërdrejt nga shoqëria në fjalë produktet e prodhuara nga ajo apo nëpërmjet saj, sipas një projekti të hartuar nga struktura përgjegjëse për modernizimin, mbi bazën e kërkesës operacionale dhe vendimit të KVK-së.

3. Në rastet kur shoqëria me kapital shtetëror disponon më pak se 50% të kapaciteteve të vlerësuara si të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës në fjalë ose nuk zotëron shumicën e kapitalit të nënshkruar të subjektit, që është krijuar për këtë qëllim, Ministria e Mbrojtjes mund të autorizojë drejtpërdrejt këtë të fundit për nisjen e procedurave për realizimin e objektit të kontratës, me produktet e prodhuara nga ajo apo nëpërmjet saj, vetëm pasi Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka aprovuar për rastin në fjalë detyrimin për furnizimin e Forcave të Armatosurave nëpërmjet shoqërisë aksionare me kapital shtetëror.

4. Edhe për rastet kur objekti i kontratës do të sigurohet nëpërmjet shoqërisë aksionare me kapital shtetëror apo të subjektit, që është krijuar për këtë qëllim, projekti teknik hartohet nga struktura përgjegjëse për modernizimin, sipas kërkesës operacionale dhe vendimit të KVK-së, miratohet nga titullari i autoritetit kontraktor në Ministrinë e Mbrojtjes dhe, mbi bazën e këtij projekti, kryhen negociatat me shoqërinë në fjalë, nëse është rasti.

5. Mënyra e pagesës, përfshirë parapagimin (total apo pjesor), nëse është rasti, apo vënia e fondeve në dispozicion të furnizuesit nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes janë pjesë e negociatave dhe pasqyrohet në kontratë.

Neni 21/2
Dialogu negociues

1. Nëse nuk ka një autorizim të drejtpërdrejtë sipas nenit 21/1, Ministria e Mbrojtjes kryen dialog negociues me shoqërinë aksionare shtetërore për të gjitha llojet e veprimtarisë që kjo shoqëri mund të realizojë sipas legjislacionit të fushës përkatëse, për të cilat kjo shoqëri disponon apo mund të sigurojë kapacitetet e nevojshme, në kohën kur kërkohet realizimi i kontratës përkatëse.

2. Struktura përgjegjëse për modernizimin i drejtohet shoqërisë aksionare shtetërore për çmim dhe disponueshmëri për objektin konkret, duke i përcaktuar afatin brenda së cilës kjo e fundit duhet të shprehet mbi kërkesën në fjalë.

3. Për raste të argumentuara, pas marrjes së çmimit dhe disponueshmërisë nga shoqëria në fjalë, struktura përgjegjëse për modernizimin mund të kryejë analizë krahasuese, nëse disponon apo mund të sigurojë në kohë informacion mbi mundësinë e realizimit të kontratave nga subjekte të tjera, që operojnë në fushën përkatëse, duke u dërguar edhe këtyre të fundit kërkesë për çmim dhe disponueshmëri.

Nëse në përfundim të analizës krahasuese rezulton si variant më i favorshëm ai me shoqërinë aksionare shtetërore, struktura përgjegjëse për modernizimin njofton subjektet e tjera mbi këtë vendimmarrje dhe vazhdohet me negocimin e kontratës me shoqërinë përkatëse.

4. Në përfundim të analizës krahasuese, struktura përgjegjëse për modernizimin mund të vendosë të mos kalojë në fazën e negocimit të kontratës me shoqërinë aksionare shtetërore, por të ftojë këtë të fundit si një ndër ofertuesit e procedurës konkurruese.

5. Shoqëria aksionare shtetërore, në rastin e pjesëmarrjes si ofertues në procedurën konkurruese, nuk ka detyrimin e paraqitjes së dokumentacionit mbi kapacitetet ligjore, financiare dhe/ose teknike, pasi kjo fazë konsiderohet e tejkaluar në kohën kur është përfshirë në listën e ofertuesve të mundshëm.

Gjithashtu, në këto raste, autoriteti kontraktor mund të parashikojë kritere vlerësimi, që kanë të bëjnë me elemente të veçanta, që mund të sjellë përzgjedhja e shoqërisë aksionare shtetërore si furnizues i Ministrisë së Mbrojtjes (punësimin e parashikuar, të ardhura të kthyera apo dhe çdo të

mirë të pritshme, që vlerësohen rast pas rasti nisur nga natyra e objektit të prokurimit).

Në rastet kur shoqëria aksionare shtetërore merr pjesë në një procedurë prokurimi, në bashkëpunim me subjekte të tjera, pavarësisht formës së bashkëpunimit ndërmjet tyre, subjekti/subjektet bashkëpunuese duhet të plotësojnë çdo kërkesë apo kriter, që u kërkohet edhe ofertuesve të tjerë, në përputhje dhe në përpjesëtim me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim apo furnizim, sipas aktmarrëveshjes përkatëse.".

15. Pas nenit 28 shtohet neni 28/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 28/1
Bashkimi i operatorëve ekonomikë

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej tyre i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në dhënien e çmimit dhe të disponueshmërisë, operatori ekonomik, të cilit i është drejtuar autoriteti kontraktor, duhet të informojë për qëllimin për të marrë pjesë si bashkim operatorësh në procedurën në fjalë.

Në dhënien e çmimit dhe të disponueshmërisë e në vijim edhe në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara të këtij vendimi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

3. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

4. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.".

16. Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2, fjalët "... brenda 5 ditëve punë nga data ..." zëvendësohen me "... brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga dita e nesërme e punës ...";

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

"5.1. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa.".

17. Pika 2, e nenit 33, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës realizohet nga struktura përgjegjëse për modernizimin, e cila mund të përfshijë në grupin e punës të ngritur për këtë qëllim edhe përfaqësues të strukturës, që ka përgatitur kërkesën operacionale. Ky grup vlerëson realizimin e detyrimeve kontraktore, sipas fazave të realizimit të kontratës dhe përgatit raportin përkatës për fazën, në të cilën është zbatimi i kontratës.".

18. Neni 34, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 34
Organizimi dhe funksionimi i KVK-së

Komisioni i veçantë i klasifikimit (në vijim "KVK") organizohet dhe funksionon si një strukturë e posaçme në Ministrinë e Mbrojtjes, me qëllim klasifikimin ose jo të kërkesave operacionale, të hartuara nga strukturat gjeneruese, si kërkesa për kontrata për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë shërbimet, teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra.".

19. Pas pikës 2, të nenit 36, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Anëtarët e KVK-së asistohen në veprimtarinë e tyre në kuadër të këtij komisioni nga specialistë sipas fushave përkatëse.".

20. Në nenin 37 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 6 shtohen fjalët "... ose personi i autorizuar prej tij.".

b) Në pikën 12 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Fjala "... "kontrata ..." zëvendësohet me fjalët "... "kërkesa operacionale ...";

ii. Pas fjalës "... përfshirë ..." shtohet "... shërbimet, ...".

II. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 401, datë 16.7.2025

PËR HAPJEN E PIKËS SË KALIMIT KUFITAR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës për qarkullimin ndërkufitar ajror të shtetasve.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 402, datë 16.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE TË KOHËZGJATJES SË MBROJTJES PERSONALE DHE BANESËS SË PERSONALITETEVE TË TJERA PAS PËRFUNDIMIT TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 4, e 14, pika 3, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KUSHTET PËR TË PËRFITUAR MBROJTJEN E VEÇANTË

1. Garda e Republikës së Shqipërisë ruan e mbron, pas përfundimit të detyrës, personalitetet apo banesën e tyre, kur u rrezikohet jeta, shëndeti apo familja, për shkak të detyrës që kanë kryer.

2. Kushtet për të përfituar ruajtjen fizike dhe mbrojtjen e banesës janë:

a) prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, shëndetin apo familjen e personalitetit apo banesën e tij, brenda gjashtë muajve nga përfundimi i detyrës;

b) prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të funksionit të mëparshëm nga personaliteti.

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË VEÇANTË

1. Kërkesa për mbrojtjen, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, i paraqitet me shkrim ministrit të Brendshëm nga vetë personaliteti i rrezikuar.

2. Kërkesa për mbrojtje përmban:

a) gjenealitetet e plota të kërkuesit;

b) një përmbledhje të fakteve dhe të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për personalitetin apo banesën e tij, të cilat e detyrojnë të kërkojë mbrojtje edhe pas përfundimit të detyrës.

3. Ministri i Brendshëm urdhëron menjëherë, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë, mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për të bërë vlerësimin e kërkesës.

4. Komisioni i Posaçëm vlerëson kërkesën e paraqitur, si autoriteti vendimmarrës për mbrojtjen e veçantë.

5. Pas shqyrtimit të kërkesës për nevojën e mbrojtjes së personalitetit apo të banesës së tij, komisioni merr vendim brenda 48 (dyzet e tetë) orëve. Vendimi u njoftohet ministrit të Brendshëm dhe personalitetit të rrezikuar.

6. Komisioni, në procesin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje, sipas këtij vendimi, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera.

7. Vendimi përmban nivelin e sigurisë dhe masat e mbrojtjes, numrin e truprojave apo të rojeve për banesën, afatin e mbrojtjes, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

8. Mbrojtja e personalitetit apo e banesës zgjat për aq kohë sa janë të pranishme rrethanat e rrezikut, por jo më shumë se një vit.

9. Me përfundimin e afatit maksimal të mbrojtjes, sipas pikës 8, të këtij kreu, Komisioni i Posaçëm vendos për:

a) vijimin e mbrojtjes me të njëjtat masa;

b) përfundimin e mbrojtjes;

c) ndryshimin e masave të sigurisë.

10. Pas vendimit të komisionit, Garda e Republikës merr menjëherë në mbrojtje personalitetin apo banesën e rrezikuar, duke zbatuar masat e përcaktuara në vendim.

III. PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË POSAÇËM

1. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga:

a) zëvendësministri i Brendshëm;

b) zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit;

c) zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës;

ç) një përfaqësues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

d) një përfaqësues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

dh) një përfaqësues nga Shërbimi Informativ i Shtetit, në nivel drejtor drejtorie;

e) një përfaqësues nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në nivel drejtor drejtorie.

2. Kryetar i Komisionit të Posaçëm, të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, është zëvendësministri i Brendshëm.

3. Pjesëmarrja në mbledhjet e komisionit është e detyrueshme. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 (pesë) anëtarë me të drejtë vote.

4. Vendimet e komisionit janë të vlefshme kur miratohen nga më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

5. Kryetari i komisionit cakton një sekretariat teknik, i cili mbështet organizimin, funksionimin dhe mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 403, datë 16.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 348, DATË 29.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES NËPËRMJET VETËPUNËSIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 348, datë 29.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Programi i vetëpunësimit mbështet sipërmarrjet e reja, nëpërmjet trajnimit për sipërmarrjet dhe zhvillimin e planeve të biznesit për kërkuesit, dhe grant për përfituesit.".

2. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas shkronjës "a", të pikës 1, shtohet shkronja "a/1", me këtë përmbajtje:

"a/1. Të mos ketë marrë pjesë më parë si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit në 5 (pesë) vitet e fundit.";

b) Në pikën 4, fjalët "... në vlerën jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë ..." zëvendësohen me "... në vlerën jo më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë...";

c) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 1 000 000 (një milion) lekë.".

3. Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i. fjalia hyrëse riformulohet:

"Punëkërkuesi duhet të aplikojë *online*, nëpërmjet portalit "*e-Albania*", për përfshirjen në program, duke plotësuar: ...";

ii. shkronja "b" ndryshohet, si poshtë vijon:

"b) Vërtetimin për individ të paregjistruar;";

b) Në pikën 14, fjalët "... brenda 5 (pesë) ditëve punë, ..." zëvendësohen me " ... brenda 10 (dhjetë) ditëve punë ...".

4. Në pikën 5, të kreut IV, togfjalëshi "... 5 (pesë) ..." zëvendësohet me "... 10 (dhjetë) ...".

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 404, datë 16.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSUAR TË VITIT 2023 PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2023, me indeksin 9.3%, të llogaritur sipas kritereve, të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për llogaritjen e bazës së vlerësuar individuale vjetore, të arritur nëpërmjet kontributeve të paguara dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2023, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.1.2025 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritura nëpërmjet pagave të periudhës 1994-2023, referuar kontributeve të paguara sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese sipas punëve dhe profesioneve, e përcaktuar me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve", të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2023, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë fillimi nga data 1.1.2025, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për pagat e periudhës, nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar sipas kritereve të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve dhe aplikohen vetëm për pensionet me datë fillimi nga data 1.1.2025 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2025.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1

Tabela e koeficientëve akumulative të indeksimit të bazës së vlerësuar	
Për pagat referuese deri në datën 31.12.1993	13.397
Për pagat e vitit 1994	13.397
Për pagat e vitit 1995	10.781
Për pagat e vitit 1996	8.365
Për pagat e vitit 1997	8.365
Për pagat e vitit 1998	6.990
Për pagat e vitit 1999	5.673
Për pagat e vitit 2000	5.167
Për pagat e vitit 2001	4.420
Për pagat e vitit 2002	4.082
Për pagat e vitit 2003	3.654
Për pagat e vitit 2004	3.319
Për pagat e vitit 2005	3.014
Për pagat e vitit 2006	2.737
Për pagat e vitit 2007	2.616
Për pagat e vitit 2008	2.310
Për pagat e vitit 2009	2.125
Për pagat e vitit 2010	2.034
Për pagat e vitit 2011	1.958
Për pagat e vitit 2012	1.883
Për pagat e vitit 2013	1.805
Për pagat e vitit 2014	1.805
Për pagat e vitit 2015	1.560
Për pagat e vitit 2016	1.560
Për pagat e vitit 2017	1.529
Për pagat e vitit 2018	1.476
Për pagat e vitit 2019	1.441
Për pagat e vitit 2020	1.400
Për pagat e vitit 2021	1.351
Për pagat e vitit 2022	1.241
Për pagat e vitit 2023	1.093
Për pagat e vitit 2024	1.000
Për pagat e vitit 2025	1.000

VENDIM
Nr. 405, datë 16.7.2025

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT PËRGJEGJËS PËR ÇËSHTJET VENDORE PËR NEGOCIIMIN DHE NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA ME VETËQEVERISJEN VENDORE PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, në formën e organizatës jofitimprurëse, për zhvillimin e kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e performancës profesionale për t'u shërbyer komuniteteve dhe për t'i ndihmuar ato në përmbushjen e funksioneve të veta dhe kompetencave, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe për përmbushjen e sfidave, që lidhen me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.

2. Ndihmesa financiare konsiston në mbulimin e kostos fillestare të themelimit të subjektit të kompetencave të përbashkëta dhe të jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të saj për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave.

3. Ministri përgjegjës për çështjet vendore merr pjesë në komitetin drejtues të subjektit të kompetencave të përbashkëta.

4. Ndihmesa financiare, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të parashikohet në buxhetin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

5. Ministri përgjegjës për çështjet vendore sigurohet që, për programet e ofruara, të merret pëlqimi paraprak nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për miratimin e programit vjetor të trajnimit, pa penguar zhvillimin e realizimin e tij, me përjashtim të rastit kur për module përkatëse vërtetohet se është kryer planifikimi për vitin akademik përkatës nga ana e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

6. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet vendore, Ministria e Financave dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 38, datë 10.6.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 10.6.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 34 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria "ERDA" sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Artan Zeneli, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Shoqëria "ALB-ITALIA COSTRUZIONI" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Adrian Prifti.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 4.4.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses "Erda" sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Alb-Italia Costruzioni" sh.p.k. (*shoqëria "Alb-Italia"*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. "Erda" sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka objekt veprimtarie shërbime të ruajtjes së sigurisë fizike. Më datë 1.1.2001, kërkuesja, në cilësinë e ofrueses së shërbimeve, ka nënshkruar një kontratë shërbimi (*kontrata*) me afat 1-vjeçar me shoqërinë "Alb-Italia", e cila fillimisht ka pasur ortak shtetin shqiptar dhe një shoqëri të së drejtës italiane, në cilësinë e përfitueses së shërbimeve. Palët kanë nënshkruar edhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të mjediseve për ruajtje. Më datë 1.1.2002, palët kanë rinovuar kontratën për një periudhë të mëtejshme 1-vjeçare, me të njëjtat kushte. Sipas kontratës, kërkuesja merrte përsipër të ruante territorin e shoqërisë "Alb-Italia", ndërsa kjo e fundit detyrohej të paguante shpenzimet për ruajtjen e objekteve, të cilat konsistonin në pagën mujore të 6 rojeve, në një vlerë totale prej 90.000 lekësh. Sipas kontratës, shoqëria "Alb-Italia" do ta bënte pagesën për shërbimet më datë 10 të çdo muaji, ndërsa parashikohej një kamatë prej 2% të shumës së papaguar për çdo ditë vonese. Duke pretenduar se shoqëria "Alb-Italia" nuk i kishte përmbushur detyrimet kontraktore kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin

e saj për të paguar detyrimin sipas kontratës, përfshirë kamatëvonesat.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3331, datë 16.7.2003 (*vendimi nr. 3331/2003*), ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë "Alb-Italia" t'i paguajë kërkueses shumën 24.814.800 lekë, të përbërë nga pagat e punonjësve në shumën 2.160.000 lekë dhe kamatëvonesat në shumën 22.654.800 lekë. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar se pala e paditur, shoqëria "Alb-Italia", ka qenë në mungesë. Ky vendim ka marrë formë të prerë për shkak se ndaj tij nuk është paraqitur ankim. Referuar parashtrimeve dhe prapësimeve të palëve të paraqitura në gjykimin kushtetues, detyrimi financiar sipas këtij vendimi është ekzekutuar tërësisht nëpërmjet shërbimit përmbarimor gjyqësor, ndërkohë që në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, nuk gjendet urdhri i ekzekutimit i lëshuar nga gjykata.

3. Pas rreth 5 vjetësh nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, me pretendimin se nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e atij gjykimi dhe as për vendimin e asaj gjykate, subjekti i interesuar, shoqëria "Alb-Italia" i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër atij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 9.10.2008, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Në vijim, më datë 19.6.2009, shoqëria "Alb-Italia" ka riparaqitur kërkesë për rivendosjen në afat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 342 akti, datë 5.10.2009, ka vendosur rrëzimin e saj. Mbi ankimin e këtij subjekti, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 382, datë 16.7.2010 (*vendimi nr. 382/2010*), ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke rivendosur në afat shoqërinë "Alb-Italia" për t'u ankuar ndaj vendimit nr. 3331/2003, me arsyetimin se ajo palë nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor të zhvilluar kundër saj për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 116, datë 3.4.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr. 116/2014*).

4. Pas rivendosjes në afat, shoqëria "Alb-Italia" ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 3331/2003, ku ka ngritur pretendime si në drejtim të padijenisë për zhvillimin e procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe në drejtim të themelit të mosmarrëveshjes, duke argumentuar se ajo gjykatë nuk ka shqyrtuar vlefshmërinë e veprimeve juridike edhe pse kontratat e lidhura mes palëve ndërgjyqëse janë nënshkruar nga një person që nuk ka pasur të drejtë të përfaqësonte shoqërinë dhe, rrjedhimisht, asaj nuk i lind asnjë detyrim prej tyre. Gjithashtu, ajo ka kërkuar nga gjykata e apelit kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 113, datë 22.1.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3331/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo gjykatë nuk ka pranuar kërkesën e shoqërisë "Alb-Italia" për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe ka vendosur ta shqyrtojë atë brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, në bazë të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në përputhje me funksionin e saj si gjykatë fakti dhe ligji dhe, në përfundim, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi e ka gjetur atë të bazuar. Kundër atij vendimi ka paraqitur rekurs shoqëria "Alb-Italia".

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1328 (173), datë 4.4.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 113, datë 22.1.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues. Kolegji Civil ka arsyetuar se fakti i padijenisë së palës rekursuese ishte tashmë i provuar me vendim të formës së prerë (vendimi nr. 116/2014, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 382/2010) dhe se gjykata e apelit mjaftonte thjesht ta konstatonte këtë fakt pa e vënë në diskutim atë, përndryshe cenohet parimi i gjësë së gjykuar. Për këtë arsye, sipas atij kolegji, gjykata e apelit duhet të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po aty, me qëllim riparimin e shkeljeve procedurale, pa i hyrë analizës së shkaqeve të themelit të çështjes, sikundër dhe ka vepruar. Në përfundim, Kolegji Civil ka sqaruar se vetë Gjykata e Lartë nuk e ka mundësinë e dërgimit të çështjes për rigjykim drejtpërdrejt në gjykatën e shkallës së parë, pasi këtë të drejtë e ka vetëm për vendimet jopërfundimtare, ndaj i ka lënë detyrë gjykatës së apelit ta bëjë këtë.

7. Më datën 18.11.2024, kërkuesja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Më datë 19.5.2025,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Kolegji i Gjykatës, më datë 14.1.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta e pronës private* përmes një *procesi jo të rregullt ligjor*, në drejtim të:

8.1 *Së drejtës së aksesit*, e cila përfshin edhe të drejtën për një zgjidhje gjyqësore të mosmarrëveshjes, pasi Gjykata e Lartë e ka diktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duke e bërë procesin e rigjykimit jo të plotë, por të cekët dhe formal. Në rastin konkret, shkaku i rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit ka qenë pavlefshmëria e njoftimeve gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë. Referuar nenit 123 të KPC-së, pavlefshmëria e vendimeve të gjykatës që mund të shqyrtohen në gjykatën e apelit ose për të cilat mund të bëhet kërkesë në Gjykatën e Lartë, vlerësohet brenda kufijve dhe rregullave të caktuara për këto mjete kundërshtimi. Vendimi i Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, e cila e kishte zgjidhur tashmë çështjen në themel, në raport me rregullin procedural të përdorur nga ajo, përbën një formalizëm të tepruar.

8.2 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj,* për shkak se Gjykata e Lartë, në tejkalim të kompetencave të saj dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 123 të KPC-së, ka urdhëruar gjykatën e apelit që ta dërgojë çështjen për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë është i panevojshëm, duke pasur parasysh se, gjykata e apelit, që ka kompetencë të shqyrtojë si çështjet e faktit, ashtu edhe çështjet e ligjit ka mundësinë që i jep neni 123 i KPC-së për të konvertuar shkakun e pavlefshmërisë (pavlefshmëria e njoftimeve) në mjetin e ankimit; gjatë shqyrtimit të ankimit të rivendosur në afat ka përmbushur standardet e gjykimit të drejtë, pasi i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka marrë një vendim të arsyetuar, të bazuar në prova, duke adresuar të gjitha aspektet e themelit të çështjes. Për pasojë, çështja është rikthyer në mënyrë të panevojshme në fazat fillestare të procesit, duke krijuar një rreth procedural të panevojshëm, në cenim edhe të parimit të sigurisë juridike. Mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë nuk i ka lënë mënyrë tjetër gjykimi gjykatës së apelit, veçse të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e bërë të pakuptimtë rigjykimin e çështjes. Rrjedhimisht, ajo gjykatë nuk ka më autonomi në rigjykim, duke e bërë vendimmarrjen e saj formale, të paragjykuar dhe të diktuar nga Gjykata e Lartë.

8.3 *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi vendimi i gjykatës së apelit në rigjykim është i paragjykuar, joefektiv dhe tërësisht formal, pasi ajo gjykatë është e detyruar të vendosë në një mënyrë të caktuar, pavarësisht parashtrimeve të palëve në procesin gjyqësor.

8.4 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar se jurisprudenca kushtetuese e kufizon gjënë e gjykuar me thelbin e mosmarrëveshjes dhe nuk e shtrin atë edhe në vendime procedurale, që nuk adresojnë thelbin e mosmarrëveshjes, siç është vendimi i Gjykatës së Lartë që lë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për rivendosjen në afat. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse sesi çështjet procedurale të pavlefshmërisë së njoftimeve ndikojnë në thelbin e mosmarrëveshjes, e cila tashmë është trajtuar dhe zgjidhur nga gjykata e apelit, si dhe nuk shpjegon se përse nuk është konsideruar shqyrtimi dhe zgjidhja e çështjes nga gjykata e apelit si e mjaftueshme për të garantuar të drejtën për një proces të drejtë dhe efektiv. Rikthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë nuk adreson asnjë të drejtë të mohuar, por vetëm krijon zvarritje të pajustifikuar të procesit.

8.5 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe parimin e ekonomisë gjyqësore*, pasi rikthimi i çështjes në fazën fillestare përbën një hap procedural të panevojshëm. Zgjatja e procesit përtej 21 vjetëve dhe perspektiva e shtyrjeve të mëtejshme, është në kundërshtim me garancitë e ofruara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, të cilat kërkojnë që konfliktet të zgjidhen në mënyrë të shpejtë dhe efektive, duke shmangur rikthimin e panevojshëm të çështjeve.

9. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "Alb-Italia",*** ka prapësuar si vijon:

9.1 Kërkuesja nuk legjitimohet, pasi nuk plotësohet kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, për sa kohë që vendimi objekt ankimi nuk është as përfundimtar, as i formës së prerë, sepse e dërgon çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit.

9.2 Pretendimi për cenimin e së *drejtës së aksesit në gjykatë* është i pabazuar pasi paradoksalisht kërkuesja e ka lidhur këtë pretendim me cenimin e mbrojtjes efektive, ndërkohë që shoqërisë "Alb-Italia" i është cenuar kjo e drejtë, duke u gjykuar në mungesë në gjykatën e shkallës së parë.

9.3 Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji dhe mbështetur në përcaktimet e shkronjës "c" të nenit 485 të KPC-së ka udhëzuar, nëpërmjet konkluzioneve të saj, për mënyrën sesi duhet të ndreqen në rigjykim të metat e konstatuara në gjykimin e çështjes.

9.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit me qëllim për të korrigjuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të konstatuar me vendim të formës së prerë. Shoqëria "Alb-Italia" nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk mund ta vinte në diskutim një fakt të tillë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimimit *(locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se në rastin e vendimeve që kanë kthyer çështjen për rishqyrtim në një gjykatë më të ulët, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t'i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jopërfundimtare që jepen gjatë një procesi gjyqësor, për shkak të pasojave të drejtpërdrejta në të drejtën kushtetuese të individit dhe pamundësisë së riparimit të shkeljes së pretenduar gjatë procesit të themelit, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit, duke përcaktuar edhe detyrimin për këtë të fundit që ta kthejë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, prandaj, në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme, Gjykata do të analizojë nëse në këtë rast përmbushen standardet/kriteret e lartpërmendura. Gjykata vëren, së pari, se e drejta kushtetuese e pretenduar e cenuar është ajo e pronës private, në formën e detyrimit financiar që qëndron në bazë të procesit gjyqësor të themelit. Kërkuesja ka pretenduar se mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë cenon, ndër të tjera, të drejtën kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj për shkak të tejkalimit të kompetencave nga Gjykata e Lartë, e cila ndikon edhe në të drejtën e saj të pronës private. Në këtë kuptim, Gjykata do të verifikojë nëse vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja në të drejtën kushtetuese të pronës private dhe nëse është e

mundur që ato të riparohen gjatë procesit të themelit në rigjykimin e çështjes.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses ka të bëjë me aspektin procedural të së drejtës substanciale të pronës private, dhe se gjykata e apelit gjatë rigjykimit është e detyruar të zbatojë detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, pra të kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Kjo do të thotë se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk mund të riparohet gjatë rigjykimit të çështjes dhe, në këtë mënyrë, së bashku me kohëzgjatjen e procesit, ndikojnë në të drejtën substanciale të pronës.

15. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin konkret plotësohen të dyja kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese si lidhur me pasojat e drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese, ashtu edhe me pamundësinë e riparimit të shkeljeve të pretenduara gjatë procesit të themelit. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar, përjashtimisht, ka natyrë përfundimtare për qëllime të gjykimit kushtetues, ndaj përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

16. Kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi objekt kërkese, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 4.4.2024, i cili, sipas informacionit të asaj gjykate, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 19.7.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë më datë 18.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së *drejtës së pronës private, së drejtës së aksesit, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së mbrojtjes, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv.* Për sa i përket pretendimit për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, Gjykata vëren se kërkuesja e ka lidhur me mënyrën e disponimit të Gjykatës së Lartë, e cila, sipas kërkueses, në tejkalim të kompetencave të saj, e ka urdhëruar gjykatën e apelit që ta dërgojë çështjen për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Për rrjedhojë, pavarësisht mënyrës sesi kërkuesja e ka ngritur këtë pretendim, në thelb, ka të bëjë vetëm me *të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* ndaj Gjykata do ta shqyrtojë në drejtim të këtij standardi. Ndërsa pretendimet e tjera të kërkueses janë më natyrë kushtetuese dhe, si të tilla, hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, prandaj do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre në themel. Në këtë pikë, Gjykata, siç ka theksuar edhe në paragrafin 14 të këtij vendimi, vlerëson që t'i analizojë pretendimet e kërkueses të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pronës private.[1]

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së pronës private në aspektin procedural

B.1.1 Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

18. Kërkuesja ka pretenduar se mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë shkon përtej kompetencave që ka parashikuar ligji, duke diktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, së cilës ajo nuk i ka lënë mënyrë tjetër vendimmarrjeje përveç kthimit të çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Sipas saj, rigjykimi në gjykatën e apelit për këtë shkak do të jetë i pakuptimtë dhe vendimmarrja e asaj gjykate do të jetë formale, e paracaktuar dhe e paragjykuar.

19. Subjekti i interesuar, shoqëria "Alb-Italia", ka prapësuar se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit me qëllim për të korrigjuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit të konstatuar me vendim të formës së prerë. Për sa kohë që ajo nuk ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund ta vinte në diskutim një fakt të tillë.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre,

[1] Gjyqtarja Marjana Semini votoi për shqyrtimin në themel edhe të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Sipas saj, qasja e Gjykatës së Lartë në vendimin objekt të ankimi kushtetues individual, vë në dyshim garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës të kërkueses, të njohur me vendim të formës së prerë dhe të ekzekutuar rreth 22 vjet më parë.

ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në kuptim të këtij standardi, Gjykata është shprehur se përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave (*shih vendimet nr. 14, datë 25.3.2025; nr. 16, datë 27.6.2022; nr. 62, datë 4.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"* është një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 20.2.2024; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka vërejtur se bazuar në nenin 141 të Kushtetutës dhe interpretimi i dispozitave që lidhen me procedurën e shqyrtimit të rekurseve është detyrë funksionale e Gjykatës së Lartë, megjithatë ajo ka pohuar se ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetues kur vihet në diskutim parimi i gjykatës së caktuar me ligj, në kuptimin që Gjykata analizon nëse Gjykata e Lartë u është përmbajtur kompetencave të saj të dhëna nga ligji (*shih vendimin nr. 14, datë 25.3.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Lidhur me kompetencën e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se neni 485 i KPC-së ka përcaktuar mënyrat e disponimit të asaj gjykate, ku për rastet që vlerësohet se rekursi është bërë për shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, ka të drejtë të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (*shkronja "b"*); të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues (*shkronja "c"*); të prishë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të dërgojë çështjen për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit (*shkronja "ç"*); të prishë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të pushojë çështjen (*shkronja "d"*); të ndryshojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe të zgjidhë përfundimisht çështjen kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve ose të provave të çështjes (*shkronja "dh"*), si dhe të lërë në fuqi të vendimin e gjykatës së apelit (*shkronja "e"*).

24. Nën dritën e garancive të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, duke pasur parasysh standardet kushtetuese të mësipërme dhe në referim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkueses, Gjykata, në vijim, vlerëson që të analizojë vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë në raport me dispozitat e KPC-së, të cilat përcaktojnë kompetencat e asaj gjykate, me qëllimin për të përcaktuar nëse ajo ka vepruar ose jo brenda këtyre kompetencave dhe, nëse kjo mënyrë e të vepruarit i ka sjellë pasoja edhe në drejtim të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkueses.

25. Gjykata konstaton fillimisht se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim, duke e justifikuar me nevojën e riparimit të një shkeljeje procedurale të gjykatës së shkallës së parë, duke referuar në nenin 467 të KPC-së, sipas të cilit gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin (shkronja "ç"). Pavarësisht se në aspektin formal Kolegji Civil e ka mbështetur vendimmarrjen në parashikimin e kësaj dispozite procedurale, ai nuk ka arsyetuar se përse riparimi i shkeljeve procedurale nga ana e gjykatës së apelit gjatë shqyrtimit të çështjes së themelit pas rivendosjes në afat të subjektit të interesuar nuk ishte e mjaftueshme, në kushtet kur ajo gjykatë nuk rezulton të ketë vënë në diskutim padijeninë e shoqërisë "Alb-Italia" për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe pavlefshmërinë e njoftimeve, të ketë konstatuar me vendimin e rivendosjes në afat të gjykatës së apelit, duke i garantuar asaj pale të gjitha të drejtat procedurale që garanton procesi i drejtë, ku përfshihen parimi i barazisë së armëve dhe i

kontradiktoritetit dhe e drejta e mbrojtjes. Thënë kjo, Kolegji Civil, pa dhënë ndonjë arsyetim, nuk ka konsideruar përfundimet e gjykatës së apelit dhe arsyetimin e saj se kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës e parë do të zvarriste procesin tej afateve të arsyeshme për shkak se nga fillimi i atij gjykimi kishte kaluar një kohë shumë e gjatë, për më tepër që shoqëria është rivendosur në afat pas 6 vjetësh. Po kështu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në pamundësi për ta dërguar vetë çështjen për rigjykim në shkallën e parë pasi ligji nuk e parashikon një kompetencë të tillë, ia ka lënë këtë detyrë gjykatës së apelit të rigjykimit.

26. Referuar kuadrit ligjor që përcakton kompetencat e Gjykatës së Lartë dhe në analizë të vendimit të Kolegjit Civil të asaj gjykate, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil, duke vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, por, në thelb, duke e detyruar atë gjykatë që ajo ta dërgojë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ka kapërcyer kompetencat e parashikuara nga neni 485 i KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Lartë ose vendos mospranimin e rekursit kur ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së, ose, në të kundërt, vendos në një nga mënyrat e përcaktuara në shkronjat "b", "c", "d", "dh" ose "e" të nenit 485 të KPC-së për vendimet përfundimtare. Gjithashtu, me vendimmarrjen e tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke arritur në përfundimin se duhet prishur një vendim gjyqësor, i cili e ka zgjidhur çështjen në themel, pasi ka zhvilluar një proces gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktoritetit, me praninë e palëve, të cilat kanë pasur mundësinë të paraqesin prova, të ngrenë pretendime dhe prapësime, të kundërshtojnë provat dhe pretendimet e palës tjetër, e ka kthyer rregullin garantues procedural në një mjet pengues për kërkuesen, si pala paditëse në atë gjykim, për të pasur një përgjigje përfundimtare me vendim të formës së prerë për themelin e çështjes së saj që, jo vetëm ka të bëjë me të drejtën e pronës, por, e ka zgjatur edhe tej çdo afati të arsyeshëm. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje Kolegji Civil ka disponuar përtej asaj që parashikon neni 485 i KPC-së, që përcakton mënyrat e disponimit të Gjykatës së Lartë, duke e bërë vendimin objekt ankimi të pambështetur në kompetencat e përcaktuara në ligj.

27. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata ka arritur në konkluzionin se Gjykata e Lartë, duke paracaktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila qartazi ka vetëm mundësinë e kthimit të çështjes për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara në ligj. Në situatën që vendimi i Gjykatës së Lartë është produkt i një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit të çështjes nga ajo gjykatë në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, kërkueses i cenohet edhe e drejta e pronës private, për rrjedhojë, pretendimi i saj për cenimin e *drejtës së pronës private* për shkak të cenimit të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të *së drejtës për tu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, është i bazuar.

28. Për sa më sipër, sipas Gjykatës, kjo mënyrë e të vepruarit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin konkret, duke paracaktuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duket se praktikisht asgjëson një shkallë gjykimi, duke e bërë ankimin në gjykatën e apelit një mjet joefektiv, në cenim edhe të së drejtës së aksesit në gjykatë. Po kështu, kjo mënyrë disponimi duket se e ka bërë edhe të drejtën e mbrojtjes së kërkueses joreale, por iluzive pasi, pavarësisht pretendimeve dhe prapësimeve të palëve gjatë rigjykimit në apel, gjykata e apelit është e detyruar të vendosë në një mënyrë të caktuar. Po kështu, duke mos e arsyetuar mjaftueshëm disponimin e saj, duket se vendimi i Gjykatës së Lartë është edhe në cenim të standardeve kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

29. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkueses që kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit në gjykatë, të drejtën e mbrojtjes, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë dhe kjo e fundit duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar këtyre pretendimeve.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës private në aspektin procedural janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 4.4.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 10.6.2025.
Shpallur, më 14.7.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini
Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses shoqëria "ERDA" sh.p.k., me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1328 (173), datë 4.4.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Çështja konkrete ka të bëjë me një mosmarrëveshje gjyqësore civile, me objekt mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore midis dy shoqërive tregtare. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2003 ka vendosur pranimin e padisë së kërkueses, duke detyruar shoqërinë "Alb-Italia" t'i paguajë kërkueses shumën 24.814.800 lekë, nga të cilat 2.160.000 lekë detyrim kontraktor i pashlyer dhe 22.654.800 lekë kamatëvonesa. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të shoqërisë "Alb-Italia" dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Në vitin 2010, gjykata e apelit ka vendosur rivendosjen në afat të apelit të shoqërisë "Alb-Italia", me arsyetimin se njoftimet e realizuara nga gjykata e shkallës së parë ishin të pavlefshme. Në vijim, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të themelit të gjykatës së shkallës së parë. Mbi bazën e rekursit të shoqërisë "Alb-Italia", Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në shkallë të dytë, me arsyetimin se duheshin riparuar shkeljet procedurale të njoftimit të lejuara nga gjykata e shkallës së parë.

3. Në këto rrethana, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, me pretendimin se kthimi i çështjes për rigjykim i ka cenuar të drejtat e pronës dhe të procesit të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit në gjykatë, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, asaj për t'u mbrojtur, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të lidhur me të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe parimin e ekonomisë gjyqësore), të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës.

4. Në analizë të kritereve të legjitimimit, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesja ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, duke evidentuar se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka kthyer çështjen për rigjykim, konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, pasi pretendimet e kërkueses kanë natyrë kushtetuese dhe se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, që pretendohet se është shkelur nga Gjykata e Lartë, nuk mund të riparohet në rigjykimin e çështjes nga gjykatat e faktit (*shih paragrafët 12 dhe 13 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmoj se vendimi objekt kundërshtimi nuk është vendim përfundimtar sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, as nga pikëpamja formale, as nga ajo substanciale. Kështu, në referim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe

liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

6. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Mbi bazën e këtij standardi, kolegjet e Gjykatës dhe Mbledhja e Gjyqtarëve kanë një praktikë konstante të zhvilluar ndër vite, sipas së cilës kërkesa të tilla nuk janë kaluar për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin uniform se vendimi gjyqësor, me të cilin është vendosur kthimi i çështjes për rigjykim, nuk është përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues. Sikurse shumica ka referuar në vendim, Gjykata në jurisprudencën e saj e ka kontrolluar vetëm një herë një vendim të tillë, pa përfunduar gjykimi i themelit të çështjes, përjashtim i cili lidhej me parimin e sigurisë juridike, në kushtet kur gjykatat e zakonshme kishin marrë në shqyrtim një ankim të paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në këtë situatë, vlerësoj, *së pari*, se nga pikëpamja formale në rastin konkret vendimi i Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim nuk është përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues dhe nuk përbën as rast përjashtimor, sipas kuptimit që i ka dhënë Gjykata në jurisprudencën e saj. Duke vepruar në këtë mënyrë, shumica nuk i është përmbajtur kufirit që duhet të ekzistojë midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor të zakonshëm dhe as parimit të subsidiaritetit që përshkon raportin midis gjykatave të zakonshme dhe vetë Gjykatës, duke e kthyer këtë të fundit në zgjatim të sistemit gjyqësor ose thënë ndryshe në gjykatë të shkallës së katërt që dikton ecurinë ligjore të procesit gjyqësor të zakonshëm.

9. Së dyti, vlerësoj se edhe nga pikëpamja substanciale nuk qëndrojnë argumentet e paraqitura nga shumica për kontrollin kushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka kthyer çështjen për rigjykim. Në këtë drejtim, shumica, në mënyrë të përmbledhur, ka evidentuar dy argumente, që përligjin kontrollin kushtetues, ndonëse çështja gjyqësore nuk kishte përfunduar në gjykatat e zakonshme: (i) Gjykata e Lartë nuk ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj; (ii) vendimi i Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për rigjykim sjell pasoja në të drejtën e pronës së kërkueses, pasi ajo duhet të kthejë shumën e parave nga ekzekutimi i vendimit.

10. Lidhur me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka analizuar rrethanat faktike të përcaktuara nga gjykatat e faktit, duke vënë në dukje se me vendimin gjyqësor të rivendosjes në afat, i cili nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve, është vërtetuar pavlefshmëria e njoftimeve në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë kontekst faktik, Gjykata e Lartë ka referuar në vendimin e saj nenin 467 të KPC-së, sipas të cilit gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin (shkronja "ç"). Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë ka evidentuar se në kushtet kur gjykimi në shkallë të parë ishte i pavlefshëm, nuk mund të zhvillohej gjykim themeli në shkallë të dytë, por duhej zhvilluar gjykimi nga e para. Në këtë mënyrë, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë ligji dhe nuk ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, ndaj ky argument i shumicës nuk përligj krijimin e një precedenti të ri për rastet përjashtimore të kontrollit kushtetues të vendimeve gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim.

11. Lidhur me pasojën e pretenduar nga kërkuesja për të drejtën e pronës, e cila, sipas shumicës, justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, jam e mendimit se nuk përbën argument të përshtatshëm kushtetues në rastin konkret. E drejta e pronës është pikërisht objekti i mosmarrëveshjes gjyqësore midis dy shoqërive tregtare që po gjykohet nga gjykatat e zakonshme, ndaj se kujt i përket kjo e drejtë midis dy personave juridikë privatë mbetet për t'u përcaktuar gjyqësisht nga gjykatat e zakonshme. Pikërisht për këtë arsye, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se cenimi

i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në konkluzion, vlerësoj se vendimi gjyqësor objekt ankimi kushtetues nuk është përfundimtar dhe as rast përjashtimor sipas jurisprudencës së Gjykatës që të mund të justifikojë shqyrtimin e tij në nivel kushtetues. Për më tepër, ai nuk duket se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtën substanciale të pronës, të pretenduar nga shumica se justifikon shqyrtimin kushtetues të atij vendimi. Për rrjedhojë, shqyrtimi i ankimit kushtetues individual nuk duhet të tejkalonte kriteret paraprake për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, prandaj kërkesa duhet të rrëzohej.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

KËRKESË
Nr. 57/19, datë 16.7.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 231, datë 17.4.2019, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i segmentit rrugor 'Pallati me Shigjeta – rrethrrotullimi 'Shqiponja"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, ku për pasuritë e llojit "truall" është bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,127,735.40 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzet) lekë (me efekt financiar zbritës prej 10,801,774.0 lekë i vlerës së miratuar me VKM-në nr. 231/2019, i ndryshuar.)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR. 231, DATË 17.4.2019, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI "SHQIPONJA", I NDRYSHUAR

	Të dhënat sipas VKM nr. 463, datë 10.06.2020											Të dhënat pas ndryshimit										
Nr.	Nr. rendor në VKM nr. 463/2020	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			VLERA Totale (LEKË)	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			VLERA Totale (LEKË)
									Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë										Sipërfaqja e shpr.(m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera lekë	
1	18	Bp Lika,Velo,Sulstarova etj.			8310	12/139	882	Truall	862.6	31,219.00	26,929,509.40	26,929,509.40	Alida KONTAKT SHPK	Haki	Maçi	8310	12/309	536	Truall	463.5	31,219.00	14,470,006.50	14,470,006.50
													Autoriteti Rrugor Shqiptar			8310	12/308	346	Truall	346	0.00	0.00	0.00
2													Ingrid Emi Dolorez Vasil Shaqir Emiljan Haxhi Miçelo	Andrea Andrea Muhamet Thanail Muharrem Dhimitër Shyqyri Ilia	Furxhi Furxhi Furxhi Shallo Shutina Muço Balla Baco	8310	12/145	53.1	Truall	53.1	31,219.00	1,657,728.90	1,657,728.90

Efekti financiar për këtë ndryshim, është me efekt zbritës në shumën 10,801,774 lekë.

Shënime:

- Nëpërmjet kësaj kërkese për shpronësim, kërkohet saktësimi i të dhënave për shpronësim për pasurinë pronë private nr. 12/139, të shpronësuar sipas VKM-së nr. 231, datë 17.4.2019 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me Shigjeta – rrethrrotullimi "Shqiponja", i ndryshuar, konkretisht me VKM-në nr. 463/2020, pasi sipas gjurmës së shpronësimi pasuria nr. 12/139 preket faktikisht vetëm për sipërfaqen prej 809.5 m².
- Sipërfaqja prej 53.1 m² i përkon pasurisë nr. 12/145 ZK 8310, e cila i shtohet tabelës së miratuar me VKM-në nr. 463/2020.
- Gjithashtu, shpjegojmë se nga verifikimi i dokumentacionit kadastral rezulton se pasuria nr. 12/139 është ndarë dhe ka vijuar në pasuritë nr. 12/309 me sip. totale 536 m², në pronësi të Alida Maçi dhe Kontakt sh.p.k. dhe nr. 12/308 m² me sip.346 m² në pronësi të ARRSH-së.

KËRKESË
Nr. 541/8, datë 15.7.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Parku Natyror 'Liqeni i Ulzës' dhe zona e mbrojtur përreth tij", me vendndodhje në Bashkinë Mat, me vlerë totale paraprake 3,532,173.70 (tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 3,532,173.70 (tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT PARKU NATYROR "LIQENI I ULZËS" DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MAT

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM									SHËNIME
								TOKË TRUALL			TOKË ARË			NDËRTESË SOCIAL-EKONOMIKE		VLERA Totale (LEKË)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar	Vlera sipas preventivit		
1	Viktor	Dod	Lleshi	2198	181/1	arë	500				500	114	57,000.00			57,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Republika e Shqipërisë			2198	181/2	arë	500				500		-			0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Republika e Shqipërisë			2198	183/2	arë	400				400		-			0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Gjok Gjele Artan Arta Astrit Alida	Zef Mark Gjok Gjok Gjok Gjok	Stojani Stojani Stojani Stojani Stojani Stojani	2198	183/1	arë	800				800	114	91,200.00			91,200.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Republika e Shqipërisë			3675	1/100	truall	271	98								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Republika e Shqipërisë			3675	1/55	truall	1,654	293								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Republika e Shqipërisë			3675	1/53	truall	2,525	80								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Republika e Shqipërisë			3675	1/54	rrugë	72	72								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Liza	Gjon	Rica	3675	1/127/ND	ndërtesë	110							110.00	1,507,360.40	1,507,360.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Shtet			3675	1/127	truall	213	213								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Shtet			3675	1/102	truall	591	591								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Adela	Ndue	Shpani	3675	1/16/ND1-N1	njësi	59							59.00	1,076,255.40	1,076,255.40	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Rudin	Gjon	Sefgjini	3675	1/16/ND1-N2	njësi	44							44.00	797,053.90	797,053.90	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Fran Eduard Bashkim Teuta Albert Anisa	Pjetër Fran Fran Fran Fran Fran	Nikolli Nikolli Nikolli Nikolli Nikolli Nikolli	3675	1/70/1	truall	180	8	413	3,304.00						3,304.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	Republika e Shqipërisë			3675	1/9	truall	2,919	967								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	Republika e Shqipërisë			3675	1/70/2	truall	39.40	16								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	Republika e Shqipërisë			3675	1/109	rruge	1,499	1392								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	Republika e Shqipërisë			3675	1/86	truall	3,179	1116								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	Republika e Shqipërisë			3675	1/16	truall	2,068	1199								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	Shtet			3675	1/15	truall	4,648	175								0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	Shtet			3675	1/16/ND4	ndërtesë	107									0.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	VLERA TOTALE PARAPRAKE															3,532,173.70	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/07/18 14:01:03 +02'00'
1be7773af16244bf9b90bf1093521e9a2025071814
005584031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)